

Pyetje dhe përgjigje për udhëtimet hyrëse në lidhje me koronavirusin SARS-CoV-2

Këtu gjeni pyetjet dhe përgjigjet më të rëndësishme.

- Të përgjithshme
- Llojet e zonave të rrezikut
- Testimi i detyrueshëm
- Karantina
- Pyetje për udhëtarët e rregullt vajtje-ardhje
- Pyetje për sektorin e transportit
- Kontrolli

Të përgjithshme

Çfarë përcakton Rregullorja për Udhëtimet Hyrëse për Koronavirusin?

Rregullorja për Udhëtimet Hyrëse për Koronavirusin rregullon, si plotësimi i rregullave të karantinës të landeve federale, në mënyrë të njësuar regjistrimin, detyrimin për test dhe detyrimin e paraqitjes së dëshmisë. Kjo përfshin një detyrim të përgjithshëm për testim dhe paraqitje të dëshmisë përkatëse për ata që hyjnë në Gjermani me transport ajror, si dhe detyrime të posaçme për testim dhe paraqitje të dëshmisë, të cilat duhen respektuar nga ata që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë pas një qëndrimi në një zonë rreziku, zonë të incidencës së lartë ose zonë të varianteve të virusit jashtë Gjermanisë.

Rregullorja për Udhëtimet Hyrëse për Koronavirusin përcakton edhe detyrimet e sipërmarrjeve të transportit dhe të operatorëve të rrjetit celular.

Llojet e zonave të rrezikut

Çfarë është një „zonë rreziku“?

Një zonë rreziku është një **zonë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë**, për të cilën Ministria Federale e Shëndetësisë, pas konsultimit me Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme dhe me Ministrinë Federale të Punëve të Brendshme, të Ndërtimit dhe Zhvillimit të Territorit kanë konstatuar një **rrezik të shtuar të infektimit** me një sëmundje të caktuar të rrezikshme ngjitëse, p.sh. infektim me koronavirusin SARS-CoV-2. Instituti Robert Koch publikon në internet në adresën <https://www.rki.de/risikogebiete> një **listë të zonave të rrezikut**, e cila përditësohet rregullisht.

Çfarë është një zonë me rrezik veçanërisht të lartë? (shpesh edhe: „zonë e rrezikut të lartë“)?

Në një zonë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë ekziston një rrezik veçanërisht i lartë, kur atje ka një incidencë veçanërisht të lartë të përhapjes së koronavirusit SARS-CoV-2 („**zonë e incidencës së lartë**“) ose kur variante të caktuara të koronavirusit SARS-CoV-2 janë shfaqur atje në mënyrë të përhapur („**zonë e varianteve të virusit**“).

Zona të incidencës së lartë mund të jenë zona me numër veçanërisht të madh të infektimeve, p.sh. disa herë më të larta se incidenca mesatare 7-ditore për 100.000 banorë në Gjermani, por të paktën me një incidencë 7-ditore prej 200.

Zona të varianteve të virusit mund të jenë zona në të cilat një variant i virusit (mutacioni) i koronavirusit SARS-CoV-2 është shfaqur në mënyrë të përhapur, i cili nuk është shfaqur në mënyrë të përhapur njëkohësisht edhe në Gjermani dhe për të cilin mund të supozohet se paraqet një rrezik të veçantë. Rreziqe të tilla të veçanta, ndër të tjera, mund të rezultojnë nga rrethana që varianti i virusit

- dyshohet ose është dëshmuar se përcillet më lehtë
- në bazë të një vetie tjetër e përshpejton përhapjen e infektimit;
- e bën më të rëndë sëmundjen
- ose që persona, të cilët tashmë janë vaksinuar ose e kanë kaluar infektimin me Covid-19 kundër variantit të virusit kanë, në rastin më të mirë, imunitet të dobët.

Ministria Federale e Shëndetësisë konstaton pas konsultimit me Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme dhe me Ministrinë Federale të Punëve të Brendshme, të Ndërtimit dhe Zhvillimit të Territorit se në cilat vende ekziston aktualisht një rrezik veçanërisht i lartë i infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2. **Se cilat zona** janë klasifikuar **aktualisht** si zona të incidencës së lartë dhe zona të varianteve të virusit, këtë mund ta mësoni nga **lista** në vijim në faqen e internetit: <https://www.rki.de/risikogebiete>.

Si e dalloni nëse po hyni në Gjermani nga një zonë rreziku, një zonë e incidencës së lartë ose nga një zonë e varianteve të virusit?

Instituti Robert Koch publikon në internet në adresën: <https://www.rki.de/risikogebiete> një **listë** që përditësohet në vazhdimësi të **zonave të rrezikut**, të **zonave të incidencës së lartë** dhe **zonave të varianteve të virusit**.

Klasifikimi si zonë rreziku, zonë e incidencës së lartë ose zonë e variantit të virusit bëhet vetëm kur mbaron dita e parë pas publikimit të konstatimit në faqen e lartpërmendur në internet. Lista e Institutit Robert Koch tregon pas emrit të landit federal, përkatësisht rajonit të landit federal në kllapa, se që **prej kur konsiderohet zona një zonë rreziku, zonë e incidencës së lartë ose zonë e varianteve të virusit**. Në fund të faqes do të gjeni një përmbledhje të zonave që kanë qenë zona rreziku në një moment të caktuar në 10 ditët e fundit, por që nuk janë të tilla aktualisht.

Sa herë përditësohen klasifikimet e zonave të udhëtimit?

Qeveria Federale verifikon vazhdimisht se a ka zona që mund të klasifikohen si zona rreziku. Prandaj, ndryshimet mund të bëhen edhe papritur, veçanërisht mund të zgjerohet lista e zonave të rrezikut. Në këtë kuadër, klasifikimi si zonë rreziku, zonë e incidencës së lartë ose zonë e varianteve të virusit bëhet vetëm kur mbaron dita e parë pas publikimit të konstatimit në faqen e lartpërmendur në internet.

Pse bëhet dallim midis zonave të rrezikut dhe zonave me rrezik veçanërisht të lartë?

Duhet të bëhet dallim midis **zonave me një rrezik të shtuar (zonë rreziku)** dhe **zonave me një rrezik veçanërisht të lartë** për t'u infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2. Në një zonë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë ekziston një **rrezik veçanërisht i lartë**, kur atje ka një incidencë veçanërisht të lartë të përhapjes së koronavirusit SARS-CoV-2 (**zonë e incidencës së lartë**) ose kur atje janë shfaqur në mënyrë të përhapur variante të caktuara të koronavirusit SARS-CoV-2 (**zonë e varianteve të virusit**).

Ky dallim bëhet për arsyen se rreziku veçanërisht i lartë për t'u infektuar në zona të tilla mund të luftohet me rregulla më të rrepta të hyrjes në Gjermani. Rregullat më të rrepta shërbejnë për të kufizuar edhe më tej infektimin me koronavirusin SARS-CoV-2 dhe për të shmangur përhapjen e shpejtë të varianteve të reja të virusit.

Testimi i detyrueshëm

Çfarë është detyrimi i ri i përgjithshëm për testim për udhëtarët që hyjnë me transport ajror në Gjermani?

Prej datës 30.03.2021, **të gjithë personat që hyjnë me avion në Republikën Federale duhet t'i paraqesin transportuesit para nisjes një test me rezultat negativ.**

Ky detyrim për testim dhe për të paraqitur dëshminë përkatëse vlen **pavarësisht nga fakti nëse transporti kryhet nga një zonë rreziku.**

Lutemi të mbani parasysh: detyrimi për të bërë testin para nisjes vlen edhe për pasagjerët që vetëm ndërrojnë avionët në një aeroport gjerman.

Mostra me tamponin, në të cilën bazohet testi, si parim i përgjithshëm, nuk duhet të jetë marrë më shumë se 48 orë para hyrjes në Republikën Federale të Gjermanisë.

Detyrimi i ri për testim dhe për paraqitjen e dëshmisë përkatëse vlen fillimisht deri në datën 12.05.2021 (përfshirë edhe këtë datë).

Informacione të tjera mund të gjeni në adresën:

<https://www.bundesgesundheitsministerium.de/coronavirus-infos-reisende/faq-testpflicht-einreisevo.html>

Çfarë kuptohet me strategji të dy testeve?

Strategjia e dy testeve parashikon testimin e detyrueshëm në kuadër të udhëtimit hyrës dhe, pothuajse në të gjitha landet federale, një testim vullnetar për ndërprerjen e parakohshme të karantinës më e hershme nga dita e pestë pas hyrjes në Gjermani.

Ju lutemi mbani parasysh se pas një qëndrimi në zonat e variantit të virusit, përfundimi i parakohshëm i periudhës së karantinës, në rrethana të caktuara, mund të përjashtohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit të një landi federal.

A duhet të testohen të gjithë udhëtarët që hyjnë nga zonat e rrezikut, zonat e incidencës së lartë dhe zonat e varianteve të virusit?

Kur keni qëndruar brenda 10 ditëve para hyrjes në Gjermani në një **zonë rreziku** (jo: zonë e incidencës së lartë ose zonë e varianteve të virusit), duhet të paraqisni një test me rezultat negativ jo më vonë se 48 orë pas hyrjes. **Mostra me tampon** për testin duhet të jetë marrë **jo më herët se 48 orë para hyrjes në Gjermani** (për kohën e saktë të hyrjes, shih më poshtë "Në cilën kohë bëhet hyrja në Gjermani?"). **Personat që hyjnë në Gjermani me transport ajror, lutemi të mbajnë parasysh detyrimin për të siguruar që para nisjes një dëshmi përkatëse të testimit, pavarësisht nëse kanë qëndruar në një zonë rreziku.**

Zyra e Shëndetit Publik mund t'ju kërkojë të paraqisni një test me rezultat negativ brenda 10 ditëve nga hyrja.

E rëndësishme: Vendimtar nuk është (vetëm) vendi ku keni nisur udhëtimin, por të gjitha vendet ku keni qëndruar në 10 ditët e fundit.

Rregulla të ndryshme vlejné për personat që hyjnë në Gjermani nga zona me një rrezik veçanërisht të lartë të infektimit (**zona të incidencës së lartë dhe zona të varianteve të virusit**). Personat, të cilët kanë qëndruar në një zonë të tillë brenda 10 ditëve të fundit para se të hyjnë në Gjermani, janë të detyruar të testohen që **para se të nisin udhëtimin për në Gjermani**. Ata duhet t'i paraqesin transportuesit (p.sh. linjës ajrore) përpara nisjes një test me rezultat negativ ose një dëshmi përkatëse mjekësore. Një test me rezultat negativ mund të kërkohet edhe në kontrollat e Policisë Federale (p.sh. në kontrollin e hyrjes në aeroport ose kontrollat pranë kufirit, kur hyni në rrugë tokësore në kufijtë e brendshëm pa kontroll kufitar). **Mostra me tampon** e testit duhet të jetë marrë **jo më herët se 48 orë para hyrjes** (për kohën e saktë të hyrjes, shih më poshtë "Në cilën kohë bëhet hyrja në Gjermani?"). Testi i kryer duhet të plotësojë kërkesat e paraqitura në <https://www.rki.de/tests> (për hollësi, shih "Cilat teste pranohen?").

Veç kësaj, në bazë të rregullave të landeve federale gjermane, personat që hyjnë në Gjermani nga zonat e rrezikut ose zonat e incidencës së lartë mund ta përfundojnë para kohe detyrimin dhjetëditor të karantinës, që ekziston në parim, duke bërë një test të dytë, përfundimi i të cilit të jetë negativ.

Në zonat me rrezik dhe zonat e incidencës së lartë, ky test i dytë zakonisht mund të kryhet jo më herët se në ditën e pestë pas hyrjes. Karantina në këtë rast përfundon me marrjen e një rezultati negativ të testit. Autoriteti kompetent mund të kontrollojë dëshminë e testit të dytë negativ deri në fund të kohëzgjatjes së përgjithshme të karantinës, d.m.th. deri në fund të ditës së dhjetë pas hyrjes.

Për zonat e variantit të virusit, periudha e karantinës është 14 ditë në bazë të dispozitave të legjislationit të landeve federale; një mundësi për ta përfunduar para kohe karantinën përmes një testi, këtu si parim përjashtohet.

Megjithatë, landet federale i zbatojnë këto rregulla në kuadër të kompetencave të tyre, ju lutemi informohuni rreth dispozitave të landit përkatës federal, në të cilin po hyni ose në të cilin po qëndroni.

Në cilën kohë ndodh hyrja në Gjermani?

Një hyrje në Gjermani sipas kuptimit të Rregullores për Udhëtimet Hyrëse për Koronavirusin konsiderohet se ka ndodhur me qëndrimin në territorin sovran të Republikës Federale të Gjermanisë.

Kur mbërrini me avion nga shtetet e Shengenit, mund të merret si bazë koha e uljes së avionit në aeroportin gjerman.

Kur hyni me mjete të tjera (nga toka ose uji), hyrja bëhet në kohën e kalimit të kufirit me Gjermaninë.

A duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e Rregullores për Udhëtimet Hyrëse për Koronavirusin pasagjerët e transportit ajror, të cilët vetëm ndryshojnë avionët në Republikën Federale të Gjermanisë? A vlen kjo edhe për ata pasagjerë, të cilët qëndrojnë në zonat ndërkombëtare të tranzitit të aeroporteve gjermane?

Po, edhe pasagjerët e transportit ajror që vetëm ndërrojnë avionët në Republikën Federale të Gjermanisë duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e Rregullores për Udhëtimet Hyrëse për Koronavirusin. Kjo vlen për të gjitha proceset e transferimit dhe në këtë mënyrë edhe për pasagjerët e transportit ajror, të cilët qëndrojnë në zonat ndërkombëtare të tranzitit në aeroportet gjermane, me synimin për të vazhduar fluturimin.

A ka përjashtime nga testi i detyrueshëm?

Personat që nuk kanë mbushur moshën gjashtë vjeç janë të përjashtuar nga detyrimi për t'u testuar.

Nga detyrimi i përgjithshëm për testim në transportin ajror ka vetëm pak përjashtime (shih më poshtë).

Në udhëtimet hyrëse në rrugë tokësore ose detare, përjashtimet varen nga **lloji i zonës së rrezikut (zonë rreziku apo zonë e incidencës së lartë)** në të cilën keni qenë në 10 ditët e fundit para hyrjes në Republikën Federale të Gjermanisë. Vendimtar nuk është vetëm vendi

ku keni nisur udhëtimin, por vendimtare janë të gjitha vendet ku keni qëndruar në 10 ditët e fundit. Përjashtimet për zonat e incidencës së lartë janë të konceptuara më me rreptësi, sepse atje ekziston një rrezik veçanërisht i lartë i infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2 krahasuar me zonat e rrezikut.

Vini re: Për zonat e variantit të virusit nuk ka përjashtime nga detyrimi për të kryer një test. Kjo do të thotë që të gjithë udhëtarët që hyjnë të moshës gjashtë vjeç e lart, që kanë qëndruar në një zonë të tillë në 10 ditët e fundit, duhet të paraqesin një dëshmi mjekësore ose një rezultat testi se nuk janë të infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2.

Përjashtimet nuk zbatohen kur manifestoni simptoma tipike të një infektimi me koronavirusin SARS-CoV-2 të tilla si kollë, ethe, rrafë ose humbje të nuhatjes dhe shijes.

Cilat janë përjashtimet nga detyrimi i përgjithshëm për testim para nisjes në udhëtimet hyrëse me avion?

Në udhëtimet hyrëse me transport ajror, personat e mëposhtëm nuk kanë nevojë të bëjnë test para nisjes:

1. Personat, të cilët transportojnë për arsye profesionale persona, mallra ose produkte përtej kufijve nëpërmjet rrugëve, hekurudhave, anijeve ose avionëve **dhe** që respektojnë në këtë kuadër në mënyrë të përshtatshme konceptet e mbrojtjes dhe të higjienës.
2. Personat që kthehen në Gjermani si pjesë e delegacioneve zyrtare përmes terminalit qeveritar në Aeroportin Berlin Brandenburg ose përmes Aeroportit të Këln/Bonit dhe të cilët kanë qëndruar më pak se 72 orë në një zonë rreziku.

Detyrimi për të bërë testin vlen edhe për pasagjerët, të cilët vetëm ndërrojnë avionët në një aeroport gjerman.

Cilat përjashtime vlejné për udhëtimet hyrëse në rrugë tokësore ose detare pas një qëndrimi të mëparshëm në një zonë rreziku?

Në **udhëtimet hyrëse** në rrugë tokësore ose detare pas një qëndrimi të mëparshëm në **një zonë rreziku** (jo zonë e incidencës së lartë ose zonë e variantit të virusit), **nuk është e nevojshme të testohen grupet e mëposhtme të personave:**

3. Personat, të cilët vetëm kanë udhëtuar nëpër një zonë rreziku dhe nuk kanë bërë ndalim të ndërmjetëm atje,
4. Personat, që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë vetëm për të kaluar tranzit dhe që largohen përsëri nga Republika Federale e Gjermanisë sa më shpejt që të jetë e mundur, për ta përfunduar tranzitin,

5. Personat që kanë qëndruar në një zonë rreziku më pak se 24 orë në kuadër të qarkullimit ndërkufitar ose që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë për një kohëzgjatje maksimale deri në 24 orë,
6. Personat, të cilët hyjnë për arsye profesionale në Republikën Federale të Gjermanisë, për të transportuar persona, mallra ose produkte përtej kufijve nëpërmjet rrugëve, hekurudhave, anijeve ose avionëve **dhe** që respektojnë në këtë kuadër si duhet konceptet e mbrojtjes dhe të higjienës.
7. Personat që kthehen në Gjermani si pjesë e delegacioneve zyrtare përmes terminalit qeveritar të Aeroportit Berlin Brandenburg ose përmes Aeroportit KëlN/Bon, të cilët kanë qëndruar më pak se 72 orë në një zonë rreziku.
8. për qëndrimet më të shkurtra se 72 orë
 - a) Personat që hyjnë në Gjermani për të vizituar të afërmit e shkallës së parë, bashkëshortin, partnerin e jetës ose partnerin me të cilin bashkëjetojnë, që nuk është anëtar i së njëjtës familje, ose në bazë të të drejtave të përbashkëta të kujdestarisë ose të vizitës,
 - b) pas respektimit në mënyrë të përshtatshme të koncepteve të mbrojtjes dhe higjienës, personat, veprimtaria e të cilëve nevojitet urgjentisht dhe është e domosdoshme për mirëmbajtjen e sistemit shëndetësor dhe kjo është e çertifikuar nga eprori, punëdhënësi ose autoriteti kontraktues,
 - c) pas respektimit në mënyrë të përshtatshme të koncepteve të mbrojtjes dhe higjienës, anëtarët e rangut të lartë të shërbimit diplomatik dhe konsullor, të parlamenteve dhe qeverive ,
 - d) Zyrtarët e policisë nga shtetet e Shengenit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre,
9. Udhëtarët e rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje dhe punonjësit ndërkufitarë, kur u përmbahen në mënyrë të përshtatshme koncepteve të mbrojtjes dhe higjienës;

Udhëtarë të rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje janë ata persona,

- të cilët vendbanimin e tyre e kanë në Republikën Federale të Gjermanisë **dhe**
- të cilëve u duhet detyrimisht të udhëtojnë në qendrën përkatëse në një zonë rreziku për të ushtruar profesionin e tyre, për të ndjekur studimet ose për trajnimin e tyre **dhe**
- që kthehen rregullisht, të paktën një herë në javë në vendbanimin e tyre.

Punonjës ndërkufitarë janë ata persona,

- të cilët e kanë vendbanimin në një zonë rreziku **dhe**
- të cilëve u duhet detyrimisht të udhëtojnë në Republikën Federale të Gjermanisë për të ushtruar profesionin e tyre, për të ndjekur studimet ose për trajnimin e tyre **dhe**
- që kthehen rregullisht, të paktën një herë në javë në vendbanimin e tyre.

10. Të afërmit dhe punonjësit e forcave të armatosura vendase dhe të huaja, në masën sa janë të mbuluar nga neni 54a i Ligjit për Mbrojtjen nga Infektimet,

11. Anëtarët e forcave të armatosura të huaja brenda kuadrit të statutit të trupave të NATO-s, statutit të trupave të Partneritetit për Paqe të NATO-s (statuti i trupave PfP) dhe statutit të trupave të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (statuti i trupave të BE) të cilët hyjnë për qëllime zyrtare në Gjermani ose që kthehen në Gjermani.

Në raste të veçuara të justifikuara, autoriteti kompetent i landit federal mund të miratojë pas kërkesës përjashtime të tjera, kur ekziston një arsye e vlefshme, ose të kufizojë përjashtimet.

Cilat përjashtime nga detyrimi për test vlejné për zonat e incidencës së lartë në udhëtimet hyrëse në rrugë tokësore ose detare ?

Në udhëtimin hyrës në rrugë tokësore ose detare pas një qëndrimi të mëparshëm në një zonë të incidencës së lartë, përjashtohen nga detyrimi për test grupet e mëposhtme të personave:

1. Personat të cilët vetëm kanë udhëtuar tranzit përmes një zone të incidencës së lartë dhe nuk kanë bërë atje një ndalesë të ndërmjetme,
2. Personat, që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë vetëm për të kaluar tranzit dhe që largohen nga Republika Federale e Gjermanisë përsëri sa më shpejt që të jetë e mundur, për ta përfunduar tranzitin
3. në qëndrimet më të shkurtra se 72 orë: personat, të cilët transportojné për arsye profesionale persona, produkte ose mallra përtej kufijve nëpërmjet rrugëve, hekurudhave, anijeve ose avionëve dhe që respektojnë në këtë kuadër në mënyrë të përshtatshme konceptet e mbrojtjes dhe të higjienës,
4. Personat që kthehen në Gjermani si pjesë e delegacioneve zyrtare përmes terminalit qeveritar të Aeroportit Brandenburg/Berlin ose përmes Aeroportit Köln/Bon, të cilët kanë qëndruar më pak se 72 orë në një zonë rreziku,
5. Personat, për të cilët, në raste të veçuara të justifikuara, autoriteti kompetent në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen nga Infektimet ka bërë përjashtime të tjera, kur ekziston një arsye e vlefshme.

A nuk ka përjashtime nga testi i detyrueshëm për zonat e varianteve të virusit?

Kur hyjnë në Gjermani nga një zonë e varianteve të virusit (d.m.th. kanë qëndruar atje në 10 ditët para hyrjes), kanë detyrimin të bëjnë testin të gjithë personat që hyjnë në vend e që kanë mbushur moshën gjashtë vjeç. Testi i detyrueshëm duhet të kryhet para hyrjes në Gjermani. Përjashtime nuk ka. Në këtë mënyrë garantohet që personat që hyjnë në vend t'i nënshtrohen një testi për koronavirusin SARS-CoV-2 përpara se të hyjnë në Gjermani. Kjo shërben për të parandaluar sa më shumë që të jetë e mundur që variante të reja, të rrezikshme të virusit të futen në vend.

Cilat teste pranohen?

Në parim, pranohen metodat e teknologjisë së amplifikimit të acidit nukleik (**PCR¹**, **LAMP²**, **TMA³**) dhe **testet e antigjenit** për zbulimin e drejtpërdrejtë të koronavirusit SARS-CoV-2.

Testet e antitrapave nuk pranohen.

Testet e shpejta të antigjenit njihen kur plotësojnë kriteret minimale të rekomanduara nga OBSH. Këtu përfshihen teste që, krahasuar me testet PCR, arrijnë një ndjeshmëri $\geq 80\%$ dhe specifike $\geq 97\%$. Parametrat e performancës së testeve të shpejta të antigjenit vendosen gjithmonë në raport me parametrat e performancës së një testi PCR dhe ndryshojnë nga prodhuesi në prodhues (shih fletën shoqëruese në kutinë e testit të shpejtë të antigjenit).

Testimet duhet të jenë kryer ose mbikëqyrur (përfshirë edhe transmetimin me video) nga një palë e tretë, e cila është e autorizuar për të kryer ose mbikëqyrur testime të tilla sipas ligjeve të shtetit në të cilin është bërë testi. Pala e tretë gjithashtu duhet të verifikojë dhe konfirmojë identitetin e personit të testuar me anë të një karte identiteti zyrtare me fotografi. Në dëshmi/në rezultatin e testit duhet të shënohet data e testimit si dhe lloji i testit që u përdor.

Dëshmia e testit duhet të paraqitet në letër ose në një dokument elektronik, respektivisht në gjermanisht, anglisht ose frëngjisht. Për krahasimin e kriterëve minimale nga autoritetet shëndetësore përgjegjëse, duhet të jenë të dukshme të dhënat për prodhuesin e testeve të antigjenit (të shpejtë).

Informacione të hollësishme mund të gjeni në faqen e internetit të Institutit Robert Koch në adresën: <https://www.rki.de/tests>

Sa kohë më parë lejohet të jetë bërë testi? Cilat parakushte të tjera duhet të plotësohen?

Mostra për testin duhet të jetë marrë jo më shumë se 48 orë para hyrjes. Në rastin e testimit të udhëtarëve që hyjnë nga zona me variante të virusit, marrja e mostrës lejohet të kryhet jo më shumë se 12 orë para nisjes (në lidhje me kohën e saktë të hyrjes, shih më lart "Në cilën kohë ndodh hyrja në Gjermani?")

Testi duhet të përmbushë kriteret e renditura nga Instituti Robert Koch në <https://www.rki.de/tests> (për më shumë hollësi shih seksionin "Cilat teste pranohen?").

Në cilën formë dhe në cilat gjuhë pranohen çertifikatat mjekësore ose rezultati i testit?

Dëshmia duhet të paraqitet në letër ose në një dokument elektronik, respektivisht në gjermanisht, anglisht ose frëngjisht.

¹ PCR: polymerase chain reaction

² LAMP: loop-mediated isothermal amplification

³ TMA: transcription-mediated amplification

A ekzistojnë rregullore të veçanta për personat që hyjnë për të nisur një punë?

Po, për **zonat e rrezikut (jo zonat e incidencës së lartë ose zonat e varianteve të virusit)** vlen: për personat që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë për të filluar një punë, autoritetit kompetent mund t'ia paraqesë, kur t'i kërkohet, dëshminë se punonjësi nuk është i infektuar me koronavirus edhe punëdhënësi ose një palë tjetër e tretë për punëdhënësin. Fjala është për një mundësi shtesë për punëdhënësit ose palët e tjera të treta (p.sh. shoqatat e punëdhënësve ose agjencitë). Kjo mundësi nuk paraqet një detyrim. Veçanërisht në rastet e punës sezonale, fakti i të punuarit së bashku (dhe në rrethana të caktuara, i të jetuarit së bashku) merret veçanërisht parasysh duke lejuar raportimin si grup.

Nëse po hyni në Gjermani me synimin për të filluar punë si i punësuar (me pagë), ju lutemi kontaktoni punëdhënësin tuaj.

Çfarë të bëj kur nuk kam mundësi të bëj para nisjes një test që plotëson kërkesat?

Ekziston mundësia edhe që testimet të kryhen ose mbikëqyren (edhe me anë të transmetimit me video) nga një palë e tretë, e cila është e autorizuar për të kryer ose mbikëqyrur testime të tilla, sipas ligjeve të shtetit në të cilin bëhet testi. Pala e tretë duhet të verifikojë dhe konfirmojë gjithashtu identitetin e personit të testuar me anë të një karte identiteti zyrtare me fotografi. Në dëshmi/në rezultatin e testit duhet të shënohet data e testimit si dhe lloji i testit që u përdor.

Nëse udhëtarët nuk kanë mundësi të marrin para nisjes një çertifikatë mjekësore ose dëshmi testi se nuk janë të infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2, testin mund ta kryejnë para nisjes transportuesit ose të organizojtë kryerjen e testit dhe, në rast se testi është negativ, të bëjnë transportimin e personit. Testimi, në të cilin mbështetet rezultati i testit duhet të plotësojë kërkesat e Institutit Robert Koch, të cilat janë publikuar në <https://www.rki.de/tests> (për më shumë hollësi shih pjesën "Cilat teste pranohen?"). Në rastin e **zonave të varianteve të virusit, mostra me tamponin** për testin duhet të **merret jo më shumë se 12 orë para nisjes së udhëtimit**.

Në këtë rast, informohuni te transportuesi juaj.

Unë po hyj në Gjermani nga një zonë rreziku (jo një zonë e incidencës së lartë ose e varianteve të virusit). Ku mund të testohem brenda Gjermanisë në rast nevojë?

Nëse po hyni në rrugë tokësore ose detare nga një **zonë rreziku**, duhet të paraqisni një test me rezultat negativ jo më vonë se 48 orë pas hyrjes në Gjermani.

Ju mund të konstatooni se ku mund të bëni një test në Gjermani duke u telefonuar numrave 116 117 ose në Internet në adresën www.116117.de. Ai që dëshiron të testohet nga mjeku i tij i familjes, duhet t'i telefonojë patjetër paraprakisht atij. Vende ku mund të testoheni ka pas hyrjes në vend edhe në aeroporte dhe në porte.

Cilat janë pasojat e një rezultati pozitiv të testit?

Një rezultat pozitiv i testit para nisjes do të thotë që ju duhet t'u përmbaheni rregullave të zbatueshme në vend në lidhje me koronavirusin SARS-CoV-2.

Kur keni dyshime, duhet izoloheni dhe të kontaktoni instancat lokale, kompetente. Mjetet e udhëtimit (automjeti, aeroplani, etj.) nuk lejohet të përdoren më në rast dyshimi.

Nëse keni hyrë në Gjermani në rrugë tokësore ose detare nga një zonë rreziku (jo nga një zonë e incidencës së lartë ose e varianteve të virusit) dhe jeni testuar vetëm në Gjermani, atëherë duhet që (në varësi të përjashtimeve nga detyrimi për karantinë sipas dispozitave të legjislacionit të landeve federale) të shkoni drejtpërdrejt në shtëpi ose në një strehim tjetër të përshtatshëm dhe të izoloheni atje për të paktën dhjetë ditë. Nëse atëherë merrni një rezultat pozitiv të testit, duhet të ndiqni udhëzimet e mëtejshme të autoritetit kompetent shëndetësor.

Ata që hyjnë në Gjermani me transport ajror ose nga një zonë me një rrezik veçanërisht të lartë (zonë e incidencës së lartë ose zonë e varianteve të virusit) nuk lejohet të transportohen pa paraqitur një rezultat negativ të testit.

Cilat janë pasojat e një rezultati negativ të testit?

Një rezultat negativ i testit para, përkatësisht, pas hyrjes (shih më lart) nuk ka në thelb asnjë pasojë. Në disa dispozita të legjislacionit të landeve federale, parashikohen përjashtime nga detyrimi i karantinës, të cilat lidhen me paraqitjen e një rezultati negativ të testit. Për këtë, ju lutemi informohuni në lidhje me përcaktimet e landit federal në të cilin po hyni ose në të cilin do të qëndroni. Një rezultat negativ i një testi të dytë të mundshëm (jo më herët se pesë ditë pas hyrjes) zakonisht do të thotë që karantina në shtëpi nuk është më e nevojshme. Ju lutemi mbani parasysh edhe se pas qëndrimit në zona të varianteve të virusit, mund të zbatohen rregulla më të rrepta sipas legjislacionit të landeve federale dhe në rrethana të caktuara mund të mos ekzistojë mundësia e ndërprerjes së parakohshme të karantinës përmes testimit.

E rëndësishme: Kur shfaqen te ju simptoma tipike të COVID-19 (të tilla si kollë, ethe ose humbje e nuhatjes ose e shijes) brenda 10 ditëve nga hyrja nga një zonë rreziku, zonë e incidencës së lartë ose zonë e varianteve të virusit, duhet të informoni menjëherë autoritetin kompetent. Simptoma të paqarta - edhe nëse testi i parë dhe/ose i dytë ka dalë negativ - duhet të sqarohen menjëherë nga një mjek.

Kush i paguan shpenzimet e testeve?

Personat që hyjnë në Gjermani pas një qëndrimi në një zonë rreziku, zonë të incidencës së lartë ose zonë të varianteve të virusit i paguajnë vetë shpenzimet e testeve. Kjo vlen si për testin e detyrueshëm në lidhje me hyrjen ashtu edhe për testin vullnetar për ndërprerjen e parakohshme të karantinës.

Karantina

Kush duhet të kalojë në karantinë në shtëpi pas hyrjes në Republikën Federale të Gjermanisë?

Kushdo që hyn në Republikën Federale të Gjermanisë, i cili ka qëndruar në një zonë të klasifikuar si zonë rreziku, zonë e incidencës së lartë ose zonë të varianteve të virusit në një

kohë të çfarëdoshme në dhjetë ditët e fundit para hyrjes, është i detyruar të shkojë drejtpërdrejt në shtëpi ose në një strehim tjetër të përshtatshëm pas hyrjes dhe të izolohet atje.

Kohëzgjatja e karantinës pas një qëndrimi në një zonë rreziku ose në një zonë e incidencës së lartë është 10 ditë sipas dispozitave të legjislacionit të landeve federale dhe 14 ditë pas një qëndrimi në një zonë të varianteve të virusit. Gjatë kësaj periudhe, nuk lejohet të pranohen vizita nga persona që nuk i përkasin familjes vetjake. Autoriteti kompetent (zakonisht [Zyra kompetente e Shëndetit Publik](#)) e monitoron respektimin e detyrimit të karantinës.

Shënim: Landet federale i zbatojnë rregullat e karantinës në kompetencën e tyre të veçantë. Qeveria federale dhe landet federale kanë rënë dakord të krijojnë rregulla sa më të njësuara në të gjithë vendin. Një urdhëresë model e karantinës shërben si **bazë pune**. Ajo përditësohet rregullisht dhe zbatohet nga landet federale nën përgjegjësinë e tyre. Në fund të fundit, i detyrueshëm është ligji i atij landi federal në të cilin po hyni ose në të cilin po qëndroni. Të gjitha landet federale kanë përgatitur për këtë [informacione specifike](#), të cilat i kanë publikuar në faqet e tyre të internetit.

A ka përjashtime nga detyrimi për karantinë?

Po, grupe të caktuara personash përjashtohen nga detyrimi i karantinës, kur mund të japin dëshmi përkatëse për këtë. Këtu bëjnë pjesë si personat që kalojnë pa ndaluar në Gjermani, ashtu edhe personat që transportojnë për qëllime profesionale produkte/mallra përtej kufijve ose puna e të cilëve nevojitet urgjentisht në sektorin shëndetësor.

Ju lutemi mbani parasysh edhe këtu legjislacionin e detyrueshëm të landit federal në të cilin po hyni ose në të cilin po qëndroni dhe merrni për këtë [informacione në adresën e lartpërmendur](#).

A duhet të raportoj vetë në Zyrën e Shëndetit Publik pasi kam hyrë në Gjermani nga një zonë rreziku?

Udhëtarët që hyjnë në vend pasi kanë qëndruar në një zonë rreziku janë të detyruar të kryejnë [regjistrimin digjital të hyrjes](#) përpara se të hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë, kur nuk ekziston ndonjë [përjashtim nga detyrimi për t'u regjistruar](#). Zyra e Shëndetit Publik ka qasje në mënyrë digjitale në të dhënat e ruajtura dhe mund të kontrollojë respektimin e karantinës në shtëpi ose t'ju kërkojë të paraqisni një dëshmi se jeni testuar ose që të pranoni një test.

Kur në raste të jashtëzakonshme (për shkak të mungesës së pajisjeve teknike ose për shkak të ndonjë problemi teknik me faqen e internetit), udhëtarët që hyjnë nuk janë në gjendje të kryejnë regjistrimin digjital të hyrjes, ata janë të detyruar të plotësojnë në letër një të ashtuquajtur [deklaratë zëvendësuese](#). Ju lutemi lexoni udhëzimet në deklaratën zëvendësuese për të mësuar se ku duhet ta dorëzoni atë (p.sh. te transportuesi ose te Deutsche Post E-POST Solutions GmbH, 69990 Mannheim). Deklarata zëvendësuese i përcillet pastaj Zyrës së Shëndetit Publik kompetente për vendqëndrimin e udhëtarit që hyn në Gjermani.

Pyetje për udhëtarët e rregullt vajtje-ardhje

A zbatohet Rregullorja për Udhëtimet Hyrëse për Koronavirusin edhe për udhëtarët e rregullt vajtje-ardhje?

Po. Rregullorja e hyrjes për koronavirusin bën dallim midis punonjësve ndërkufitarë, udhëtarëve të rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje dhe udhëtarëve të përditshëm vajtje-ardhje:

Udhëtarë të përditshëm vajtje-ardhje janë personat që në kuadër të qarkullimit ndërkufitar kanë qëndruar jashtë vendit për më pak se 24 orë ose që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë për një kohëzgjatje deri 24 orë.

Udhëtarë të rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje janë personat që vendbanimin e tyre e kanë në Republikën Federale të Gjermanisë dhe që e kanë detyrimisht të nevojshme të shkojnë jashtë vendit, për të ushtruar profesionin e tyre, për të ndjekur studime ose për t'u trajnuar në qendrën ku e ushtrorjnë profesionin e tyre, ku studiojnë ose ku trajnohen dhe të cilët kthehen në vendbanimin e tyre rregullisht, të paktën një herë në javë.

Punonjësit ndërkufitarë janë njerëz që e kanë vendbanimin e tyre jashtë vendit dhe që e kanë detyrimisht të nevojshme të hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë për të ushtruar profesionin e tyre, për të ndjekur studime ose për t'u trajnuar dhe që kthehen rregullisht në vendbanimin e tyre, të paktën një herë në javë.

Përrjashtimet nga detyrimi për test, të përshkruara në këtë seksion **zbatohen vetëm** kur personat në fjalë **nuk shfaqin simptoma tipike të infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2** të tilla si kollë, ethe, rufë ose humbje të nuhatjes dhe shijes.

Cilat janë detyrimet që kanë udhëtarët e përditshëm vajtje-ardhje?

Ata përjashtohen nga **detyrimi për t'u regjistruar** vetëm kur hyjnë në Gjermani pas një qëndrimi në një zonë rreziku ose në një zonë të incidencës së lartë, por jo në një zonë të varianteve të virusit. Ata udhëtarë të përditshëm vajtje-ardhje që nuk janë të përjashtuar nga kërkesa e regjistrimit, sepse vijnë nga një zonë e varianteve të virusit, duhet ta kryejnë regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani vetëm një herë në javë. Në këtë rast, si vendbanimi në Gjermani duhet të shënohet adresa e vendit të punës, qendrës së trajnimit ose e një vendi tjetër, me të cilin ekziston një lidhje në konstelacionin konkret. Përveç kësaj, në aplikacion duhet të zgjidhet edhe një përjashtim përkatës; kur është e nevojshme, mund të bëhen specifikime të tjera në fushën bosh në tekst.

Nga **detyrimi për testim** ata përjashtohen vetëm kur kanë qëndruar në një zonë rreziku. Pas qëndrimit në një zonë të incidencës së lartë ose zonë të varianteve të virusit, si parim, para se të nisen për në Gjermani ata duhet të testohen (për përjashtime të mundshme shih më poshtë "Cilat përjashtime mund të ofrojnë për udhëtarët e rregullt vajtje-ardhje autoritetet e landeve federale?").

Çfarë detyrimesh zbatohen për punonjësit ndërkufitarë dhe udhëtarët e rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje?

Punonjësit ndërkufitarë dhe udhëtarët e rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje kanë **detyrimin që të regjistrohen (për udhëtimet hyrëse ose dalëse më të shkurtra se 24 orë, megjithatë, shihni rregullat për udhëtarët e përditshëm vajtje-ardhje).**

Edhe udhëtarët e rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje dhe punonjësit ndërkufitarë, të cilët nuk janë udhëtarë të përditshëm vajtje-ardhje duhet ta kryejnë vetëm një herë në javë regjistrimin e detyrueshëm. Në këtë rast, si vend banimi në Gjermani duhet të shënohet adresa e vendit të punës, qendrës së trajnimit ose e një vendi tjetër, me të cilin ekziston një lidhje në konstelacionin konkret. Përveç kësaj, në aplikacion duhet të zgjidhet edhe një përjashtim përkatës; kur është e nevojshme, mund të bëhen specifikime të tjera në fushën bosh të tekstit.

Nga **detyrimi për testim** ata përjashtohen vetëm kur kanë qëndruar në një zonë rreziku. Pas qëndrimit në një zonë të incidencës së lartë ose zonë të varianteve të virusit, për ta vlen pra, veç detyrimit për regjistrim edhe detyrimi për test (për përjashtime të mundshme shih më poshtë "Cilat përjashtime mund të ofrojnë për udhëtarët e rregullt vajtje-ardhje autoritetet e landeve federale?").

Cilat përjashtime mund të ofrojnë për udhëtarët e rregullt vajtje-ardhje autoritetet e landeve federale?

Autoriteti kompetent në kuadër të Ligjit të Mbrojtjes nga Infektimet mund të nxjerrë, kur ekziston një arsye e vlefshme, përjashtime nga detyrimi për testim në rastet e udhëti meve hyrëse në rrugë tokësore ose detare nga një zonë e incidencës së lartë (§ 4 paragrafi 2, numri 5 i Rregullores së Udhëtimeve Hyrëse për Koronavirusin). Një arsye e vlefshme mund të ekzistojë, për shembull, në rastet e diplomatëve, udhëtarëve të rregullt vajtje-ardhje ose ekipeve të montimit me misione urgjente.

Autoriteti kompetent mund të lejojë një përjashtim edhe me anë të një dispozite të përgjithshme administrative. Përjashtimet mund të bëhen, kur ekziston një arsye e vlefshme, për shembull, në përgjithësi për një grup personash, një qëllim udhëtimi dhe/ose për një kohëzgjatje të caktuar.

Cili autoritet mund të lejojë hyrjen në Gjermani pa testim, sipas përjashtimit në kuadër të § 4 paragrafi 2, numri 5 të Rregullores së Hyrjes për Koronavirusin?

Autoriteti kompetent përcaktohet në përputhje me § 54 të Ligjit të Mbrojtjes nga Infektimet sipas legjislacionit përkatës të landit federal.

Pyetje për sektorin e transportit

Çfarë detyrimesh zbatohen për sektorin e transportit? Në cilat raste nuk ka detyrim për regjistrim/testim për sektorin e transportit?

Përrjashtimet nga detyrimi për testim të përshkruara në këtë seksion **zbatohen vetëm** kur personat në fjalë **nuk shfaqin simptoma tipike të infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2** të tilla si kollë, ethe, rufë ose humbje të nuhatjes dhe shijes.

Për personat që, për arsye profesionale, transportojnë njerëz, produkte ose mallra përtej kufijve në rrugë, hekurudhë, anije ose avion vlejnë detyrimet e mëposhtme:

Në rastin e një qëndrimi të mëparshëm në një **zonë rreziku**, që nuk është as zonë e incidencës së lartë dhe as zonë e varianteve të virusit, personeli i transportit përjashtohet nga detyrimi për regjistrim dhe detyrimi për test, pavarësisht nga kohëzgjatja e qëndrimit në zonën e rrezikut ose në Gjermani.

Në rastin e qëndrimit të mëparshëm në një **zonë e incidencës së lartë**, personeli i transportit i nënshtrohet detyrimit për regjistrim.

Kur personat kanë qëndruar në një zonë rreziku për më pak se 24 orë në kuadër të qarkullimit ndërkufitar ose kur ata udhetojnë në Republikën Federale të Gjermanisë vetëm për një kohëzgjatje deri në 24 orë, personeli i transportit mund t'i referohet gjithashtu këtij përjashtimi dhe nuk i nënshtrohet detyrimit për regjistrim. Personeli i transportit përjashtohet nga detyrimi për test kur personeli ka qëndruar në një zonë e incidencës së lartë për 72 orë ose kur do të qëndrojë në Gjermani vetëm për 72 orë.

Në rastin e qëndrimit të mëparshëm në një **zonë të varianteve të virusit**, personeli i transportit i nënshtrohet detyrimit për regjistrim dhe atij për testim.

Të gjitha përjashtimet janë të lidhura me zbatimin më mënyrë të përshtatshme të koncepteve të mbrojtjes dhe higjienës.

A vlejnë edhe për personelin e transportit përjashtimet nga detyrimi për test për zonat e rrezikut dhe për zonat e incidencës së lartë?

Në grupin i personave që transportojnë për arsye profesionale persona të tjerë, produkte ose mallra përtej kufijve bëjnë pjesë edhe të gjithë anëtarët e ekuipazheve.

A duhet të deklarojë një vendbanim në Gjermani personeli i transportit, që i nënshtrohet detyrimit për regjistrim, por i cili qëndron vetëm për pak kohë në Gjermani, përkatësisht që vetëm kalon tranzit me automjetet?

Të gjithë personat, që i nënshtrohen detyrimit të regjistrimit duhet të deklarojnë një vendbanim në Gjermani, pasi kjo është mënyra e vetme për të përcaktuar se cili autoritet është kompetent për ta. Kjo është e nevojshme edhe për personat që i nënshtrohen përjashtimit nga karantina sipas legjislacionit të një landi federal, sepse autoriteti kompetent duhet të jetë në gjendje të kontrollojë, nëse fakti i përjashtimit është i zbatueshëm me të vërtetë.

Në rastin e personelit të transportit, duhet të deklarohet ai vend që është më i praktikueshëm, në rastin e drejtuesve të automjeteve, p.sh. selia e punëdhënësit në Gjermani, vendi i shkarkimit ose një vend tjetër, me të cilin ekziston një lidhje në konstelacionin konkret.

Kontrolli

Si kontrollohet detyrimi për test dhe karantinë?

Udhëtarët që hyjnë në Gjermani pasi kanë qëndruar në një **zonë rreziku, zonë të incidencës së lartë ose zonë të varianteve të virusit** janë të detyruar, që para hyrjes në Republikën Federale të Gjermanisë të bëjnë [regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani \(DEA\)](#). Autoriteti kompetent (zakonisht Zyra e Shëndetit Publik) ka qasje në mënyrë digjitale në të dhënat e ruajtura dhe mund të kontrollojë respektimin e karantinës në shtëpi ose t'ju kërkojë të paraqisni një dëshmi se jeni testuar ose që të pranoni një test.

Kur hyrja në Gjermani nga një **zonë e incidencës së lartë** ose **zonë e varianteve të virusit** bëhet me anë të një **transportuesi**, atij duhet t'i paraqitet para nisjes edhe një dëshmi testimi. Pavarësisht nëse përdoret apo jo një transportues, autoriteti i ngarkuar me kontrollin policor të qarkullimit ndërkufitar (zakonisht **Policia Federale**) mund të kërkojë paraqitjen e një dëshmie testimi, kur kryen detyra të policisë kufitare dhe gjithashtu të kontrollojë nëse është përmbushur detyrimi për t'u regjistruar.

Si kryhen kontrollet kur hyni me automjet ose me tren nga një zonë e incidencës së lartë ose zonë e varianteve të virusit?

Në udhëtimet hyrëse me tren nga një zonë e incidencës së lartë ose zonë e varianteve të virusit, janë transportuesit që kontrollojnë nëse udhëtarët kanë me vete një test me rezultat negativ. Kur një dëshmi e tillë nuk paraqitet, transportimi është i ndaluar. Në transportin hekurudhor ndërkufitar ose në transportin detar ndërkufitar të distancave të afërta, këto kontrolle mund të kryhen edhe gjatë transportimit. Rregulloret nuk zbatohen për transportin publik lokal të pasagjerëve.

Në udhëtimet hyrëse me automjet, autoritetet kompetente mund të kryejnë kontrolle rastësore pranë kufirit, për të përcaktuar nëse udhëtari ka me vete një test me rezultat negativ, kur udhëtari hyn në Gjermani nga një zonë me një rrezik veçanërisht të lartë.

Pavarësisht nga rrethana, nëse po udhëtoni apo jo me një transportues, dëshminë e testit duhet t'ia paraqisni, kur t'jua kërkojë, autoritetit të ngarkuar me kontrollin policor të qarkullimit ndërkufitar në kuadër të kryerjes së detyrave të policisë kufitare.

Si zbatohet detyrimi për test - a është e mundur të imponohet bërja e një testi?

Kushdo që hyn në Gjermani pas qëndrimit në një zonë rreziku dhe nuk paraqet një test me rezultat negativ brenda 48 orësh duhet të presë një gjobë (shih më poshtë "A ka sanksione? Cilat janë ato konkretisht?") dhe duhet të pranojë një vizitë mjekësore për të përjashtuar një infektim me SARS-CoV-2.

Si e mëson Zyra e Shëndetit Publik që testi i dikujt ka dalë me rezultat pozitiv?

Laboraret kanë detyrimin që të raportojnë për testet PCR të kryera në Gjermani. Kjo do të thotë: laboraret duhet t'ia raportojnë rezultatet pozitive të testeve Zyrës së Shëndetit Publik. Kur testet e antigjenit janë pozitive, duhet të kryhet për confirmim një test PCR.

Si e mëson Zyra e Shëndetit Publik që testi i dikujt ka dalë me rezultat negativ? A ia raporton mjeku rezultatin Zyrës së Shëndetit Publik? A merr personi që bën testin një dëshmi dhe ia raporton rezultatin vetë Zyrës së Shëndetit Publik?

Laboratorët nuk ia raportojnë rezultatet negative të testeve Zyrave të Shëndetit Publik. Prandaj një rezultat negativ të testit ose një dëshmi nga mjeku që thotë se personi nuk është i infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2, udhëtarët që hyjnë në Gjermani dhe të cilët kanë qëndruar më parë në një zonë rreziku, zonë të incidencës së lartë ose zonë të varianteve të virusit duhet t'ia dëshmojnë, kur e kërkon, Zyrës kompetente të Shëndetit Publik ose një instance tjetër të përcaktuar nga landi federal.

A ka sanksione? Cilat janë ato konkretisht?

Shkeljet e detyrimeve të lartpërmendura për t'u regjistruar, testuar ose për të kaluar në karantinë në shtëpi përbëjnë shkelje ligjore. Autoritetet lokale kompetente mund të vendosin për këtë gjë deri në 25.000 Euro.

Fletë me udhëzime dhe informacione për regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani

Rregulla për koronavirusin SARS-CoV-2/ COVID-19 për personat që hyjnë në Gjermani dhe për regjistrimin digjital të hyrjes për njerëzit nga zonat e rrezikut në disa gjuhë.

Informacione të tjera

- **Informacione aktuale për udhëtarët që hyjnë në Gjermani:**

Këtu mund të mësoni se çfarë duhet të mbani parasysh kur jeni me pushime jashtë vendit, cilat rregulla janë në fuqi dhe çfarë duhet të dinë udhëtarët që hyjnë në Gjermani pas qëndrimit në një zonë rreziku.